



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:298707

Datë: 14.05.2021

Numri i dokumentit: 01780169

C.nr. 730/2019

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini me bashkëpunëtorin profesional Adnan Hajdari, në çështjen kontestimore të paditësit NN nga fshati NN, Komuna e Vitisë, të cilën me autorizim e përfaqëson, Liman Musa, avokat nga Ferizaj, rr. Rr. Driton Islami p.nr., kundër të paditurës Komuna e Vitisë -DKA, të cilën me autorizim e përfaqëson, Ekrem Shabani, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, vlera e objektit të kontestit 1, 555.50 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 05.05.2021, jashtë seance, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit Uran Azemi nga fshati NN, Komuna e Vitisë, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Vitisë - DKA dhe, detyrohet e paditura, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar, për 10 vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj 50% të një page bazë, respektivisht shumën prej 229.50 Euro, ndërsa në emër të ushqimit ditorë, për periudhën 18.04.2017 deri më 18.12.2020, për 663 ditë të pranisë në punë, t'ia kompensoj dy euro në ditë, respektivisht shumën prej 1, 326 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1, 555.50 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve, nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 260 Euro.

A r s y e t i m

Paditësi Uran Azemi, përmes përfaqësuesit së tij me autorizim, me padinë e datës 27.12.2019 e gjithashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga Gjykata, të aprovojë kërkesëpadinë paditësit për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe për 10 vite të përvojës së punës 50% të një page bazë, respektivisht shumën prej 229.50 Euro, dhe shpenzimeve të ushqimit ditorë nga 2 Euro në ditë, për 663 ditë pune, të llogaritur nga data 18.04.2017 deri më 18.12.2020, shumën prej 1, 326 Euro të gjitha në shumë të përgjithshme prej 1, 555.50 Euro.

Bazën ligjore për kërkesën e tij, paditësi mbështeti në nenin 35, par. 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, për shkak se është në marrëdhënie pune në Gjimnazin "Kuvendi i Lezhës", në Viti, ku edhe punon nga viti 2006, dhe e paditura nuk ia ka kompensuar kërkesat që i takojnë sipas kontratës kolektive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar: për përpilim të padisë shumën prej 104 Euro, për një seancë të mbajtur gjyqësore, shumën prej 135 Euro, për një seancë të dështuar shumën prej 67 Euro dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 21 Euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 327 Euro.

E paditura, në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke e cilësuar si të pa bazuar në ligj, për faktin se DKA-Komuna e Vitisë nuk është përgjegjëse për moszbatimin e kontratës kolektive të vitit 2017, të cilën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe SBASHK, dhe nuk kanë ndarë mjete buxhetore për kompensimin e këtyre beneficioneve që dalin nga Kontrata Kolektive, andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Kontraten e punës me numer 05-590/2015, të datës 01.09.2015, Vërtetimin për përvojën e punës, me numër 3056, të datës 11.12.2019, vërtetimin për ditën e pranisë së paditësit në punë, me numër 3623, të datës 19.04.2021, llistën e pagave të muajit nëntor të vitit 2019.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit Uran Azemi është e bazuar, dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Nga provat materiale të administruara gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike; Paditësi Uran Azemi, është në marrëdhënie pune – mësimdhënës në Gjimnazin “Kuvendi i Lezhës” në Viti nga data 01.09.2006, ku edhe ende punon si mësimdhënëse e rregullt, ndërsa paga bazë e paditësit është 459 Euro. Nga data 18.04.2017 deri më 18.12.2020, ka qenë i pranishëm në punë 663 ditë, fakte këto të vërtetuara me kontratën e punës, vërtetimin për përvojën e punës dhe vërtetimin për ditët e pranisë së paditësit në punë.

Faktin se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit me nr.prot.3056, të datës 11.12.2019, të lëshuar nga Gjimnazin “Kuvendi i Lezhës” në Viti, sipas të cilit, paditësi me datë 01.09.2016 e kishte themeluar marrëdhënien e punës në këtë shkollë ku ende e vazhdon punën. Paga bazë e paditësit në shumë prej 459 Euro, u vërtetua në bazë të Regjistrit të pagave, sipas të cilit paditësi është anëtar SBASHK-ut dhe për këtë paguan anëtarësi. Gjithashtu, fakti se paditësi për periudhën 18.04.2017 deri më 18.12.2020 ka qenë i pranishëm në punë 663 ditë, u vërtetua me vërtetimin me nr.prot. 3623, të datës 19.04.2021, të lëshuar nga Gjimnazin “Kuvendi i Lezhës” në Viti.

Meqenëse në bazë të provave të administruara u vërtetua gjendja faktike si më lart, gjykata e obligoi të paditurën që paditësit, t’ia kompensojë shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes për kompensimin e ushqimit, gjykata u bazua në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, i cili ka paraparë kompensimin e ushqimit në punë nga 2 Euro për një ditë pune. Ndërsa për shpërblimin jubilar gjykata u bazuar në nenin 35 par. 8, pika 8.2 të Kontratës Kolektive, i cili ka paraparë “punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: [...] për 10 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 50% të një page bazë [...]”.

Sa i përket periudhës se kërkesës së paditësit pas datës 18.04.2020 e deri me 18.12.2020, gjykata konsideron se Kontrata Kolektive zbatohet edhe për këtë periudhë, për shkak se sipas nenit 45 të Kontratës Kolektive është përcaktuar “[...] nëse nga kontrata kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit [...]”. Kontrata Kolektive ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa nuk ka dëshmi se ndonjëra nga palët kontraktuese, është tërhequr.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës, të cilat u gjetën si të pa bazuara, për shkak se palët kontraktuese të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (Ministria e Arsimit

Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2 të kësaj Kontrate kanë përcaktuar: “Dispozitat e këtij Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Për më tepër, nenin 37 kanë përcaktuar se “palët nënshkruese të këtij kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, pasi që e paditura e ka humbur kontestin në këtë rast, andaj edhe obligoi që paditësit t’ia paguajë shpenzimet e procedurës si në vijim: për përpilimin e padisë 104 Euro, për taksë gjyqësore 21 Euro si dhe për një seancë gjyqësore 135 Euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 260 duke u bazuar edhe në Rregulloren për Tarifat e Avokatëve të Kosovës. Ndërsa, kërkesa për kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit për një seancë të shtyrë nuk u aprovua për shkak se, seanca e datës 28.04.2021, është shtyrë me kërkesë të përfaqësuesit të paditësit.

Lidhur me taksën gjyqësore për padë, gjykata, duke u bazuar në nenin 6.2 të UA.Nr.01/2017 për unifikimin e taksave gjyqësore, e obligoi paditësin që të paguaj shumën shtesë prej 10 Euro, duke u bazuar në nenin 12.1 të udhëzimit të lartcekur, sipas të cilit, për kërkesat në para vlera e të cilave është prej prej 1001 Euro deri në 2, 500 Euro, taksa për padë është 30 Euro, ndërsa, me rastin e dorëzimit të padisë, për taksë gjyqësore ka paguar vetëm 20 Euro.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr. 730/2019, datë 05.05.2021

Gjyqtari,
Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, duke llogaritur pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa eventuale dorëzohet përmes kësaj gjykate.